  - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 te LPP dhe nenin 75 te VKM 285/2021.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 1/1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 7. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 9 : Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 10 Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)

Shtojca 11- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 12 : Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraprak)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

---

## Shtojca 1.

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

---

f) Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë _____</b>	

## Shtojca 1/1.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët]

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

c) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimin dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

---

<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>
<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi i mallrave</b>	<b>Norma e fitimit</b>

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	





**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

**LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE**

**Data:** \_\_\_\_\_

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**

\_\_\_\_\_

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
<b>Artikulli</b>	<b>Përshkrimi i mallit</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi per njësi</b>	<b>Çmimi total për artikull (3 x 4X)</b>	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total (Mallrat)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					
<b>Nënshkrimi</b>					
<b>Vula</b>					

---

<b>Datë</b> _____	
-------------------	--

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

---

#### Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Përfaqësuesi i Ofertuesit

#### Nënshkrimi

#### Vula

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

### KANCELERI DHE ZARFA

Nr.	Emërtimi	Specifikime teknike
1	Dyll i kuq 500gr ( 1 Kutii)	Në formë shufre , 500 gr(10 copë për 50 gr)
2	Vinovil	Ngjitës vinovil i lëngshëm, me përmbajtje aceto-vinili, pa përbërës të dëmshëm apo toksikë për lëkurën, në ngjyrë të bardhë.
3	Spango	Spango të jetë material polipropilen. Peshë 1kg të jetë e barabartë me minimum 1670 metra dhe maksimumi 1675 metra, trashësia të jetë minimumi 2mm dhe maksimumi 2.5 mm.
4	Natriban i madh transparent	Ngjitës në formë shiriti, me ngjitje vetëm në njërin krah, transparent, përmasa <b>50mm x 120m, 55micron</b> (+-1%)
5	Plumce	Materiali aliazh plumbi që të lere gjurmë lehtësisht , diametër 14mm, trashësi 6mm, të jetë e shpuar në dy anët e trashësisë. Ana hyrëse me dy vrima me diameter 3mm secila, ana dalëse, nje hapje 10mm , përmasat (+-2%)

6	Kapse/Tela makinash	Kuti me kapse makine me material që të ofrojë një shpim të pastër nëpër fletët e shumta të letrës pa i dëmtuar ato, për të siguruar një kapje të qëndrueshme. Kokat e thumbave të kërkojnë më pak përpjekje për kapjen e letrave. Permasat : 24/6 (24x6mm); Materiali : bronzi ; sasia: 1000pcs/kuti
7	Kapse aktesh nr.3 (treshe ) (Klipse)	Kapse aktesh teli 2.8cm (1 pako = 100 kapse aktesh 2.8cm)
8	Kapse aktesh nr.5 (pesëshe ) (Klipse)	Kapse aktesh teli 5cm (1 pako = 100 kapse aktesh 5cm)
9	Kapse aktesh të vogla nr.2 (dyshe) (Klipse)	Kapse aktesh teli 2.5cm (1 pako = 100 kapse aktesh 2.5cm)
10	Dosje me lidhëse me lembe , 15cm	Materiali : Karton i qëndrueshëm , i papërthyeshem, me lidhëse me material pambuku nga tre anët, jo më të shkurtëra se 30cm, me lembe në tre ane, jo më të shkurtëra se 24cm, të kapura me percina. Dosja të ketë gjerësi 15cm , për të mundësuar ruajtjen sa më mirë të volumeve të dokumentave. Dosja të jetë ngjyrë blu.
11	Dosje me mekanizëm	Dosje me mekanizëm 8cm me kuti, kutia të jetë me veshje të plastifikuar me etiketë, me ngjyra të ndryshme, mekanizmi me kapse brenda metalike.
12	Dosje me unaza	Dosje A4 me 4 unaza me xhep për etiketë për identifikim të lehtë të kontekstit të dokumenteve përbërëse. Formatimi : A4; Materiali : Plastik , <b>gjerësi 7.5cm</b>
13	Dosje me Llastik	Dosja material pl. të mbyllet me ndihmën e një llastiku, në mënyrë që të ruajë sa më mirë materialet në brendësi si dhe për t'u lëvizur lehtësisht, me etiketë për identifikim të lehtë të kontekstit të dokumenteve përbërëse, etiketa të vendoset në faqen ballore, përfaqësohet në mes të saj. Formatimi me përmasta 345 mm x 250 mm (+-1%); ngjyra të ndryshme. Peshë e dosjes jo më pak se 100gr
14	Bojë vulash	Bojë Vule me shishe (30ml )
15	Kuti mesatare ambalazhi për koli	Me përmasta (30x20x30 )cm (+-1%), karton i ricikluar, me trashësi ...,me dy shtresa të valëzuara dhe tre shtresa kartoni, profili I kartonit, me spesor jo më pak se 6mm. Në kuti të jetë i dallueshëm prodhuesi. Me logo të Postës
16	Kuti e madhe ambalazhi për koli	Me përmasta (60x40x60 )cm (+-1%), karton i ricikluar, me trashësi .., me dy shtresa të valëzuara dhe tre shtresa kartoni, profili I kartonit, me spesor jo më pak se 6mm. Në kuti të jetë i dallueshëm prodhuesi. Me logo të Postës

17	Rapidografe blu	Stilolaps rapidograf me majë fine 0.8 mm, ngjyrë blu dhe rezistente ndaj ujit, drites dhe kohes, nuk zbehet dhe nuk lë njolla. Me kapak dhe kapëse metalike. Keto specifikime te jene te shkruara ne trup, ose ne skede teknike te prodhuesit.
18	Rapidografe me ndërrim rezervash blu	Rapidografe me ndërrim rezervash blu, maja 0.5mm
19	Rezerva rapidi	Rezerva Rapitografi me ngjyrë blu
20	CD	CD-R 800MB, me kapak plastik
21	Blllok contact note 75 x 75mm	Përmasa minimumi 75mm x 75 mm , me minimumi 500 fleta me ngjyra të ndryshme
22	Blllok contact note 125 x 75mm	Përmasa afërsisht 125mm x 75 mm, me minimumi 500 fleta me ngjyra të ndryshme
23	Penarola (evidencjatore) me ngjyra të ndryshme	Penerola me ngjyra të ndryshme, me majë ne formë dalte minimumi 4.5mm, e cila ndihmon për evidentime ose nënvijëzime. Ngjyra shumë të ndezura fosforeshente e cila thahet menjëherë. Pako me 4 ngjyra.
24	Kuti arshive	Kuti të jetë e qëndrueshme, material (100% karton, përmasat: minimumi 40x28x18 cm (+-1%), trashësia e kartonit afërsisht minimum 2.5 mm (+-1%)
25	Zarf i vogël 114 x 162 mm	Materiali :Rezistent ndaj lagështirës; Përbërja: Letër me peshë 80 gr/m <sup>2</sup> ; Ngjyra: Në pjesën e jashtme e bardhë, pjesa e brendshme me ngjyrë; Mbyllja: Në formë të drejtë (jo trekëndësh), Ngjitësi i zarfit të jetë i fortë (i veshur me letër adezive), i cili hiqet në momentin e ngjitjes në mënyrë që pas ngjitjes të mos hapet, (me hapje në pjesën e gjerë në përmasën 162mm). Të jetë stampuar logo e Postës Shqiptare. përmasat e zarfave, janë përcaktuar sipas standartit të përmasave ISO 216, i cili përcakton dhe tolerancat sipas përmasave.
26	Zarf i mesëm 190 x 260 mm	Përbërja: Letër me peshe 80gr/m <sup>2</sup> ; Ngjyra: Në pjesën e jashtme e bardhë, pjesa e brendshme me ngjyrë; Mbyllja: Në formë të drejtë në pjesën e ngushtë të zarfit. Ngjitësi i zarfit të jetë i fortë (i veshur me letër adezive) që hiqet në momentin e ngjitjes në mënyrë që pas ngjitjes të mos hapet (me hapje në pjesën në përmasën 190mm). Të jetë stampuar logo e Postës Shqiptare. përmasat e zarfave, janë përcaktuar sipas standartit të përmasave ISO 216, i cili përcakton dhe tolerancat sipas përmasave.

27	Zarfa të mëdhenj 230x330 mm	Përbërja: Letër me peshë 80gr/m <sup>2</sup> ; Ngjyra: Në pjesën e jashtme e bardhë, pjesa e brendshme me ngjyrë; Mbyllja: Në formë të drejtë në pjesën e ngushtë të zarfit. Ngjitësi i zarfit të jetë i fortë (i veshur me letër adezive) që hiqet në momentin e ngjitjes në mënyrë që pas ngjitjes të mos hapet (me hapje në pjesën e permasës 230mm). Të jetë stampuar logo e Postës Shqiptare. përmasat e zarfave, janë përcaktuar sipas standartit të përmasave ISO 216, i cili përcakton dhe tolerancat sipas përmasave.
28	Zarf kartoni për shërbimin EMS 230 x 330 mm	Zarf kartoni, me përmasa 230x330mm (23x33cm) për shërbimin EMS, me hapje në pjesën e përmasës 330mm, stampuar logo e shërbimit EMS (Blu me portokalli). Me xhepore me permase min (22.5 x 16)cm, për vendosje të dokumentave shoqëruar. Përmasat e zarfave, janë përcaktuar sipas standartit të përmasave ISO 216, i cili përcakton dhe tolerancat sipas përmasave.Trashësia e kartonit të zarfit, duhet të jetë minimumi 250 micron.
29	Zarf kartoni për shërbimin EMS 400 x 600 mm	Zarf kartoni, me përmasa 400x600mm (40x60cm) për shërbimin EMS, me hapje në pjesën e përmasës 400mm, stampuar logo e shërbimit EMS (Blu me portokalli). Me xhepore me permase min (22.5 x 16)cm, për vendosje të dokumentave shoqëruar. Përmasat e zarfave, janë përcaktuar sipas standartit të përmasave ISO 216, i cili përcakton dhe tolerancat sipas përmasave.Trashësia e kartonit të zarfit, duhet të jetë minimumi 250 micron.
30	Lapsa plumbi HB	Lapsa plumbi (1pako=12copë) lapsa me gomë, me vija portokalli dhe të zezë 2 HB ose ekuivalente.
31	Fletë karboni	Fletë karboni cilësore, që nuk le shenja në letër. Pako me 100 fletë.
32	Korrektor	Korrektor me furçë 20 ml
33	Ngjitës (stick) 10gr	Ngjitës (stick) 10gr
34	Ngjitës (stick) 40 gr	Ngjitës (stick) 40 gr
35	Bllloqe A4	Blllok format 20cm x 28 cm , me kapak imitim lëkure, me cepa metalik, minimumi 150 fletë.
36	Zarfe special me ajër Z-1 320x455mm)	Përbërja: Letër me peshë 120gr/m <sup>2</sup> ; Ngjyra: Në pjesën e jashtme ngjyrë mjalti, pjesa e brendshme me mbulesë fleksibël mbrojtëse e mbushur me ajër ; Mbyllja : Në formë të drejtë , në pjesën e ngushtë të zarfit. Ngjitësi i zarfit të jetë i fortë (i veshur me letër adezive) që hiqet në momentin e ngjitjes në mënyrë që pas ngjitjes të mos hapet.



37	Zarfe special me ajër Z-2 (250x350mm)	Përbërja: Letër me peshë 120gr/m <sup>2</sup> ; Ngjyra: Në pjesën e jashtme ngjyrë mjalti, pjesa e brendshme me mbulesë fleksibël mbrojtëse e mbushur me ajër ; Mbyllja : Në formë të drejtë , në pjesën e ngushtë të zarfit. Ngjitësi i zarfit të jetë i fortë (i veshur me letër adezive) që hiqet në momentin e ngjitjes në mënyrë që pas ngjitjes të mos hapet.
38	Zarf special me ajër Z-3 (180x260mm)	Përbërja: Letër me peshë 120gr/m <sup>2</sup> ; Ngjyra: Në pjesën e jashtme ngjyrë mjalti, pjesa e brendshme me mbulesë fleksibël mbrojtëse e mbushur me ajër ; Mbyllja : Në formë të drejtë , në pjesën e ngushtë të zarfit. Ngjitësi i zarfit të jetë i fortë (i veshur me letër adezive) që hiqet në momentin e ngjitjes në mënyrë që pas ngjitjes të mos hapet.
39	Stilolapsa të thjeshtë	Stilolapsi i thjeshtë me majë sferike dhe rezistente. Të ketë precizion të lartë gjatë shkrimit mbi çdo lloj letre, boja të thahet shpejt si dhe të kryhet një shkruajtje e butë.
40	Gërshërë	Gërshërë zyre minimumi 20cm
41	Mbajtëse kancelarie cilësore	Mbajtëse kancelarie, me 6 vende për aksesorët, material druri.
42	Makinë kapëse metalike 30fl	Makinë për qepje dokumentash metalike, pincë inoksi, të qepë minimumi 35fletë .Të përdorë tela 24/6
43	Makinë llogaritëse universale me shirit letre (strice)	Makinë llogaritëse e cila mundëson emetimin e veprimeve të kryera në shirit letre, me minimumi 12 shifra dhe me përmasa minimumi 97mm x 190mm
44	Shirit me ngjyrë (ndarëse)	Ndarese plastike në formë flamuri, përmasa afërsisht 45x12mm me 8 ngjyra të ndryshme me nga 25fletë

\*Shënim: Për të gjithë zërat që janë dhënë përmasat pranohet tolerancë (+-1%) e përmasave.

## Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

#### Sasia e mallit që kërkohet:

#### Afatet e lëvrimit:

Nr.	Emërtimi	Njësia e matjes	Sasia
1	Dyll i kuq 500gr ( 1 Kuti)	kuti	350
2	Vinovil	kg	100
3	Spango	kg	1000
4	Natriban i madh transparent	cope	6000
5	Plumce	kg	500
6	Kapse/Tela makinash	kuti	12000
7	Kapse aktesh nr.3 (treshe ) (Klipse)	kuti	1300
8	Kapse aktesh nr.5 (pesëshe ) (Klipse)	kuti	1300
9	Kapse aktesh të vogla nr.2 (dyshe) (Klipse)	kuti	1300
10	Dosje me lidhëse me lembe , 15cm	cope	9000
11	Dosje me mekanizëm	cope	600
12	Dosje me unaza	cope	500
13	Dosje me Llastik	cope	9000
14	Bojë vulash	cope	1000
15	Kuti mesatare amballazhi për koli	cope	4000
16	Kuti e madhe amballazhi për koli	cope	1100

17	Rapidografe blu	cope	500
18	Rapidografe me nderrim rezervash blu	cope	300
19	Rezerva rapidi	cope	1000
20	CD	cope	300
21	Bllok contact note 75 x 75mm	cope	1500
22	Bllok contact note 125 x 75mm	cope	2000
23	Penarola (evidencjatore) me ngjyra të ndryshme	pako	900
24	Kuti arshive	cope	1000
25	Zarf i vogël 114 x 162 mm	cope	3000000
26	Zarf i mesëm 190 x 260 mm	cope	1800000
27	Zarfa të mëdhenj 230x330 mm	cope	2200000
28	Zarf kartoni për shërbimin EMS 230 x 330 mm	cope	5000
29	Zarf kartoni për shërbimin EMS 400 x 600 mm	cope	1500
30	Lapsa plumbi HB	cope	1000
31	Fletë karboni	pako	600
32	Korrektor	cope	1500
33	Ngjitës (stick) 10gr	cope	1000
34	Ngjitës (stick) 40 gr	cope	1000
35	Bllloqe A4	cope	1000
36	Zarfe special me ajër Z-1 (320x455mm)	cope	15000
37	Zarfe special me ajër Z-2 (250x350mm)	cope	15000
38	Zarf special me ajër Z-3 (180x260mm)	cope	11000
39	Stilolapsa të thjeshtë	cope	15000

---

40	Gërshërë	cope	100
41	Mbajtëse kancelarie cilësore	cope	200
42	Makinë kapëse metalike 30fl	cope	300
43	Makinë llogaritëse universale me shirit letre (strice)	cope	300
44	Shirit me ngjyrë (ndarëse)	pako	100

**Afatet e lëvrimit:** Malli do te dorezohet brenda **90 (nëntëdhjetë) ditëve** kalendarike nga dita e nenshkrimit te kontrates mes paleve.

**Vendi i dorëzimit:** Malli do te dorezohet ne magazine e Drejtorise se Posta Shqiptare sh.a. konform dokumentacionit ligjor dhe teknik te kërkuar nga autoriteti kontraktor dhe te marre persiper ne oferte nga ofertuesi.

---

## Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

---

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

---

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, 2019, 2020 dhe 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 99 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet.

#### **2.3Kapaciteti teknik:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- 
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 9001- 2015 ose ekuivalente me të (Certifikata duhet të jetë e leshuar nga organizmat e vleresimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë).

2.3.3 Per zarf kartoni per sherbimin EMS me përmasa 230 x330mm operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga firma prodhuese ose akt marreveshje bashkëpunimi ose leter angazhimi me firmen prodhuese per mallin objekt prokurimi ose nga distributori i autorizuar nga Prodhuesi.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të ketë kapacitete të stafit të tij për të prodhuar gjithë sasinë e kërkuar në këtë prokurim si dhe listë pagesat sipas formatit E-Sig, ku numri i punonjësve të siguruar të jetë jo më i vogël se 5 (pese) punonjës për **muajin e fundit të maturuar nisur** nga data e hapjes së ofertave. Për plotësimin e kësaj kërkesë, operatori ekonomik duhet të dorëzojë një vërtetim për numrin e punonjësve të lëshuar nga Administrata Tatimore që vërteton se subjekti ka paguar kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për **muajin e fundit të maturuar**, shoqëruar me listëpagesën e dorëzuar pranë organeve tatimore për **muajin e fundit të maturuar**.

**Për përmbushjen e këtij kriteri në fazën e ofertimit, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST.**

**Sqarim :** përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).*

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra për artikujt 6, 10, 13, 17, 18, 36,37,38,42 të kërkuar sipas listës së artikujve në Shtojcën 5, Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Mosparaqitja e mostrave të kërkuara si dhe mospërputhja e tyre me specifikimet teknike është kusht për skualifikim.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: <ul style="list-style-type: none"><li><b>Informacione për nënkontraktorin</b></li></ul>
---



Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

## B: DEKLARATA

### Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se, deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
  - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
  - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
  - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
  - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
  - a) çmimet ;
  - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
  - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
  - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

## C: DEKLARATA

### Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:</p> <p>Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.</p>
